

VENDIM
Nr. 154, datë 11.12.2015

**MBI MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR CERTIFIKIMIN E OPERATORIT TË
SISTEMIT TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 58, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 26 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, i ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.12.2015, pasi shqyrtoi draftin e përgatitur nga grupi i punës të rregullave për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike dhe relacionin përkatës,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit Ahmeti